



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRI

Nr. 1521 / 4 Prot.

Tiranë, më 13.09.2023

URDHËR

Nr. 268, datë 13.09.2023

PËR NJË SHITESË NË URDHRI NR. 158, DATË 26.04.2022 "PËR MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 7, pikës 2, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 516, datë 1.7.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 247, datë 20.3.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit për periudhën 2015-2020 dhe Miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 e të Pasaportës së Indikatorëve", të Urdhrit nr. 334, datë 7.10.2020, të Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore", shkresës së Ministrisë së Drejtësisë nr. 1521/2, datë 05.07.2023 "Kërkohet rishikimi i Planeve të Integritetit dhe shtimi i masave për zbatimin e rekomandimit të GRECO",

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 158, datë 26.04.2022 "Për miratimin dhe zbatimin e Planit të Integritetit", bëhet shtesa si më poshtë:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"Miratohet shtesa në përmbajtje të Planit të Integritetit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, sipas matricës bashkëlidhur".

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit e institucionit.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR



I. Matrica e Planit të Veprimit

Objektiivi 1: Përmirësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të procesit politikëbërës në turizëm dhe mjedis, përmes ristrukturimit organizativ të Ministrisë

Nr.	Risiko dhe ngjarjet e mundshme	Kategoriate faktoreve të rrishtit Burim/impakti	Masat prioritare • Prioriteti i lartë • Prioriteti i moderuar • Prioriteti i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës.	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afatit i fundit për zbatimin e aktiviteteve
1.1/1	Mungesa e trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme në lidhje me për etikën dhe antikorrupsionin për anëtarët e kabinetit pranë ministrit;	Burimet Njerëzore/Operacional	Mesatar	<ol style="list-style-type: none"> Trajnime periodike për etikën dhe antikorrupsionin për anëtarët e kabinetit pranë ministrit; Paketë informimi për veprimtarinë dhe aktivitetet ku anëtarët e kabinetit pranë ministrit marrin pjesë dhe janë të angazhuar; Kryerja e një trajnimi fillestar në fillimet e martes së detyrës nga anëtarët e kabinetit pranë ministrit për integritetin dhe antikorrupsionin 	DMBNJASH-i Anëtarët e kabinetit Gjastëmujori i parë i vitit 2024
1.1/2	Paqartësi të proceseve të punës për veprimtarinë dhe fushën e përgjegjësisë që ndjekin anëtarët e kabinetit pranë ministrit;	Operacionet (Procesi)/Operacional	Mesatar	<ol style="list-style-type: none"> Të hartohen përshkrime pune për veprimtarinë dhe fushën e përgjegjësisë që ndjekin anëtarët e kabinetit pranë ministrit; 	DMBNJASH-i Anëtarët e kabinetit Përshkrime pune Gjastëmujori i parë i vitit 2024

<p>1.1/3</p>	<p>Mungesa e parashikimeve të garta në Kodin e Etikës së MTM-së në lidhje me detyrimet për zbatim nga ana e anëtarët e kabinetit pranë ministrit;</p>	<p>Burimet Njerëzore/Operacional</p>	<p>Mesatar</p>	<p>1. Të rishikohet Kodi i Etikës së ministrisë duke përfshirë si subjekt zbatim edhe anëtarët e kabinetit pranë ministrit;</p>	<p>Kuadri i brendshëm rregullator i Ministrisë ka mungesë të dispozitave në lidhje me detyrat e anëtarëve të kabinetit pranë ministrit dhe rregullimin e marrëdhënieve të tyre me drejtoritë teknike dhe me funksionet e tjera të ushruara në institucion si: Kordinator i të Drejtës për Informim, Kordinator i Konsultimit Publik, Kordinator i Menaxhimit Financiar.</p>	<p>Burimet Njerëzore/Operacional</p>	<p>Mesatar</p>	<p>1. Të rishikohet rregulloria e brendshme e ministrisë për pozicionet e punës dhe detyrat e anëtarëve të kabinetit pranë ministrit dhe rregullimin e marrëdhënieve të tyre me drejtoritë teknike dhe me funksionet e tjera të ushruara në institucion si: Kordinator i të Drejtës për Informim, Kordinator i Konsultimit Publik, Kordinator i Menaxhimit Financiar</p>	<p>DMBNJASH-i Anëtarët e kabinetit Përshkrime pune Gjashëmujori i dytë i vitit 2024</p>
--------------	---	--	----------------	---	---	--	----------------	--	---



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

KOORDINATORI KOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT

Lënda: Raportim për ndjekjen dhe zbatimin e masave për rekomandimet e vlerësura pjesërisht të zbatuara dhe të pazbatuara nga GRECO

Të dhëna të përgjithshme	
Rekomandimi 2	i) plane konkrete integriteti të miratohen dhe zbatohen për të gjitha ministratë, duke përfshirë analizën sistematike të rreziqeve të lidhura me integritetin me të cilat mund të përballen ministrat dhe këshilltarët politikë në ushtrimin e detyrave të tyre dhe mekanizmat e monitorimit dhe përputhshmërisë, dhe ii) të hartohen dhe zbatohen masa të përshtatshme korrigjuese që synojnë posaçërisht personat me funksione të larta ekzekutive.
Statusi	Pjesërisht i Zbatuar
Institucioni	Ministritë + Ministrat e Shtetit
Ecuria-deri në korrik 2023	<ul style="list-style-type: none">- Ministrive të Linjës iu është kërkuar me shkresë të rishikojnë Planet e Integritetit me masa për anëtarët e kabinetit të ministrave. Afati 30 shtator 2023.- Ministrave të Shtetit iu është kërkuar me shkresë të hartojnë Plane Integriteti. Afati 30 shtator 2023.- MD, MFE dhe MBZHR do të hartojnë plan të ri integriteti. Afati 15 dhjetor 2023.
Raportimi	Në proces, Është përgatitur drafti për shtesën në Planin e Integritetit për MTM së bashku me matricën.

Të dhëna të përgjithshme	
Rekomandimi 3	Harmonizimin dhe rritjen e koherencës së natyrshme të kuadrit ligjor dhe institucional në luftën kundër korrupsionit dhe integritetit të zyrtarëve publikë, veçanërisht në lidhje me personat me funksione të larta ekzekutive, për shembull, duke hartuar norma dhe rregullore në një manual dhe duke ofruar udhëzime mbi detyrimet e çdo kategorie dhe për rolin e çdo organi përgjegjës.

Statusi	Pjesërisht i Zbatuar
Institucioni	Kuvendi; ILDKPI, DAP
Ecuria deri në korrik 2023	<ul style="list-style-type: none"> - Projektligji është ende në Kuvend. - Aktet e tjera do të bëhen në vijim pasi ligji të hyjë në fuqi.
Raportimi	Pertu plotësuar

Të dhëna të përgjithshme

Rekomandimi 4	i) Kodi Etik Ministror ekzistues të plotësohet me udhëzime konkrete për zbatimin e tij në lidhje me konfliktet e interesit dhe çështje të tjera që kanë lidhje me integritetin (p.sh. dhuratat, kontaktet me palët e treta, lobimin, etj.); ii) të sigurohet funksionimi efektiv i Komisionit të Etikës, ose i çdo mekanizmi tjetër të besueshëm mbikëqyrjeje dhe sanksionesh, përfshirë edhe në lidhje me kryeministrin, dhe iii) rregullat etike të plotësohen me shembuj ilustrues dhe mekanizma zbatues për këshilltarët politikë.
Statusi	Pjesërisht i Zbatuar
Institucioni	MSHSSH
Ecuria deri në korrik 2023	<ul style="list-style-type: none"> - Janë hartuar dy manualët e kërkuar në maj 2023. 1. <i>Udhëzime konkrete për zbatimin e tij në lidhje me konfliktet e interesit dhe çështje të tjera që kanë lidhje me integritetin.</i> 2. <i>Manual Shpjegues për zbatimin nga ana e Anëtarëve të Këshillit të Ministrave të detyrimeve lidhur me dhuratat, favoret, premtimet dhe trajtimet preferenciale.</i>
Raportimi	Pertu plotësuar

Të dhëna të përgjithshme

Rekomandimi 5	Anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe këshilltarët politikë t'i nënshtrohen ndërgjegjësimit sistematik për çështje që lidhen me integritetin, duke përfshirë Kodin Etik Ministror dhe legjislacionin dhe kuadrin kundër korrupsionit dhe integritetit, nëpërmjet trajnimeve të rregullta, udhëzimeve të dedikuara dhe këshillimit konfidencial.
Statusi	Pjesërisht i Zbatuar
Institucioni	MSHSSH; MD; ASPA

Ecuria deri në korrik 2023	<ul style="list-style-type: none"> - 17 maj 2023, zhvilluar seancë trajnimi dhe informim për anëtarët e KM për Kodin Ministror dhe Manualin Shpjegues për zbatimin nga ana e Anëtarëve të Këshillit të Ministrave të detyrimeve lidhur me dhuratat, favorët, premtimet dhe trajtimet preferenciale. - Ka filluar përgatitja e kurrikulës “antikorrupsioni dhe integriteti” për anëtarët e kabineteve politike, për tu adaptuar nga ASPA
Raportimi	Përu plotësuar

Të dhëna të përgjithshme	
Rekomandimi 6	Të ndërmerren masa plotësuese për ta bërë procesin e konsultimit të projekt-legjislacionit parësor dhe dytësor me interes publik specifik më efektiv për palët veçanërisht të interesuara, edhe nëpërmjet faqeve zyrtare të internetit më të lehta për t’u përdorur nga përdoruesit
Statusi	Pjesërisht i Zbatuar
Institucioni	KM + Ministrinë
Ecuria deri në korrik 2023	- është publikuar video e informimit për konsultimin publik të akteve, e aksesueshme në link: https://konsultimipublik.gov.al/
Raportimi	Janë reflektuar ndryshimet e kërkuara në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, linku, https://turizmi.gov.al/konsultime/

Të dhëna të përgjithshme	
Rekomandimi 7	i) të përcaktohen rregulla të detajuara se si personat e besuar me funksione të larta ekzekutive angazhohen në kontakte me lobistët dhe palët tjera të treta që kërkojnë të ndikojnë në legjislativin qeveritar dhe veprimtari të tjera, dhe ii) të sigurohet transparencë e mjaftueshme për qëllimin e këtyre kontakteve (formale dhe joformale), identitetin e personit (personave) me të cilët (ose në emër të të cilëve) janë marrë kontaktet dhe çështjet specifike të diskutuara.
Statusi	Pjesërisht i Zbatuar
Institucioni	KM; MD; DAP

Ecuria deri në korrik 2023	- Nuk ka zhvillim
Raportimi	Përfunduar

Të dhëna të përgjithshme	
Rekomandimi 8	Që abstenimi i një ministri ose zëvendësministri për të qenë pjesë e një vendimi të Këshillit të Ministrave për shkak të një konflikti të mundshëm interesi të regjistrohet në procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit të Ministrave, siç kërkohet me ligj.
Statusi	Pjesërisht i Zbatuar
Institucioni	MSHSSH
Ecuria deri në korrik 2023	- Nuk ka zhvillim
Raportimi	Përfunduar

Të dhëna të përgjithshme	
Rekomandimi 9	Të sigurohet që rregullat e qarta për kufizimet pas largimit nga detyra të zbatohen si për anëtarët e Këshillit të Ministrave ashtu edhe për këshilltarët politikë dhe se të zbatohet një mekanizëm efektiv zbatues në lidhje me këto rregulla për të gjithë personat të besuar me funksione të larta ekzekutive.
Statusi	Pazbatuar
Institucioni	KM, Ministrinë, DAP
Ecuria deri në korrik 2023	- Nuk ka zhvillim
Raportimi	Në proces, është planifikuar që në trajnimet që do të zhvillohen për etikën dhe antikorrupsionin të përfshihen rregulla të qarta për kufizimet pas largimit nga detyra që të zbatohen si për anëtarët e Këshillit të Ministrave ashtu edhe për këshilltarët politikë.

Të dhëna të përgjithshme

Rekomandimi 13	(i) të kryhet një analizë e gjerë mbi kuadrin ligjor dhe praktikën e dhurimeve dhe sponsorizimeve private për Policinë e Shtetit dhe që, nën dritën e gjetjeve të saj, të miratohen rregulla për të hequr dorë nga dhurimet/sponsorizimet private për Policinë ose, si minimum, të kufizohen rreziqet e korrupsionit dhe konfliktet e interesit në këtë drejtim; dhe (ii) që dhurimet dhe sponsorizimet e marra të publikohen në baza të rregullta (përfshirë edhe në internet), duke treguar natyrën dhe vlerën e secilit dhurim si dhe identitetin e donatorit.
Statusi	Pjesërisht i Zbatuar
Institucioni	MB, PSH
Ecuria deri në korrik 2023	- Nuk ka zhvillim
Raportimi	Për tu plotësuar

Të dhëna të përgjithshme	
Rekomandimi 14	Që politikat për ofrimin e shërbimeve shtesë nga Policia e Shtetit në këmbim të pagesës të marrin parasysh në mënyrën e duhur rreziqet për korrupsion dhe konfliktin e interesit.
Statusi	Pazbatuar
Institucioni	MB, PSH
Ecuria deri në korrik 2023	- Nuk ka zhvillim
Raportimi	Për tu plotësuar

Të dhëna të përgjithshme	
Rekomandimi 16	Që parimet etike dhe rregullat e sjelljes të përfshira në Rregulloren e Policisë së Shtetit të plotësohen me një manual që përmban udhëzime praktike që merr parasysh specifikat e Policisë së Shtetit, shumëllojshmërinë e detyrave dhe dobësitë.
Statusi	Pazbatuar

Institucioni	MB, PSH
Ecuria deri në korrik 2023	- Hartuar dhe miratuar manuali i PSh: Për rregullat e sjelljes dhe parimet etike të Policisë së Shtetit (urdhër 980/30.6.2023 i DPSH)
Raportimi	Per tu folur esca!

Të dhëna të përgjithshme	
Rekomandimi 17	(i) shtimin e trajnimit fillestar dhe gjatë punësimit të punonjësve të policisë në lidhje me çështjet e integritetit, si dhe trajnimin e specializuar të hetuesve që merren me çështjet e korrupsionit dhe krimit ekonomik; (ii) ngritjen e një sistemi dhe caktimin e personave të trajnuar të besimit për të ofruar këshillim konfidencial mbi çështjet e etikës dhe integritetit për të gjithë stafin e policisë.
Statusi	Pjesërisht i Zbatuar
Institucioni	MB, PSH, Akademia e Policisë
Ecuria deri në korrik 2023	- Janë zhvilluar trajnime - Në proces të tjerat
Raportimi	Per tu folur esca!

Të dhëna të përgjithshme	
Rekomandimi 18	Marrjen e masave për rritjen e qëndrueshmërisë së drejtuesve të lartë të Policisë së Shtetit, pavarësisht ndryshimeve politike në vend.
Statusi	Pazbatuar
Institucioni	MB, PSH, Akademia e Policisë
Ecuria deri në korrik 2023	- Nuk ka zhvillim
Raportimi	Per tu folur esca!

Të dhëna të përgjithshme	
---------------------------------	--

Rekomandimi 19	Drejtuesit e drejtorive të Policisë së Shtetit të emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm.
Statusi	Pazbatuar
Institucioni	MB, PSH
Ecuria deri në korrik 2023	- Ka një iniciativë për ndryshime në ligj nga PSh
Raportimi	Për t'u plotësuar

Të dhëna të përgjithshme	
Rekomandimi 20	i) që funksionet më të ekspozuara ndaj rreziqeve të integritetit të kenë përparësi gjatë procesit të rivlerësimit (vetingut), në lidhje me planin e integritetit dhe mjetet e tjera ekzistuese të menaxhimit të rrezikut; dhe ii) që kontrollet për integritetin e kandidatëve të kryhen në kontekstin e ndryshimeve të pozicioneve dhe ngritjes në detyrë dhe në intervale të rregullta gjatë karrierës së punonjësve të policisë.
Statusi	Pjesërisht i Zbatuar
Institucioni	MB, PSH
Ecuria deri në korrik 2023	- Nuk ka zhvillim
Raportimi	Për t'u plotësuar

Të dhëna të përgjithshme	
Rekomandimi 21	Rregullat për pranimin dhe deklarimin e dhurimeve nga stafi i policisë t'i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe zbatimit të duhur.
Statusi	Pjesërisht i Zbatuar
Institucioni	MB, PSH
Ecuria deri në korrik 2023	- Ka një iniciativë për ndryshime në ligj nga PSh
Raportimi	Për t'u plotësuar

Të dhëna të përgjithshme	
Rekomandimi 22	Punonjësit e 'Illyrian Guard' t'i nënshtrohen të njëjtave masa ligjore dhe rregullatore (përfshirë rregullat e zbatueshme të sjelljes dhe rregullat e transparencës në procedurat e prokurimit publik) si punonjësit e Policisë së Shtetit.
Statusi	Pjesërisht i Zbatuar
Institucioni	MB, PSH
Ecuria deri në korrik 2023	- Nuk ka zhvillim
Raportimi	Reali plotësuar

Të dhëna të përgjithshme	
Rekomandimi 23	Hartimi i rregullave të qarta për kufizimet pas largimit nga detyra, të shoqëruara nga një mekanizëm efektiv zbatues, për punonjësit e policisë.
Statusi	Pazbatuar
Institucioni	MB, PSH
Ecuria deri në korrik 2023	- Ka një iniciativë për ndryshime në ligj nga PSh
Raportimi	Reali plotësuar

Të dhëna të përgjithshme	
Rekomandimi 24	Të sigurohet efektiviteti i zbatimit të ligjit për sinjalizuesit, duke përfshirë trajnimin dhe informimin e rregullt të stafit të policisë për masat e mbrojtjes së sinjalizuesve.
Statusi	Pjesërisht i Zbatuar
Institucioni	MB, PSH
Ecuria deri në korrik 2023	- Janë zhvilluar trajnime
Raportimi	Reali plotësuar

--	--



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRI

№ 3807 / Prot.

Tiranë, më 26/4 /2022

URDHËR

№ 158, datë 26.4 .2022

PËR

MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 7, pikës 2, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 516, datë 1.7.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 247, datë 20.3.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit për periudhën 2015-2020 dhe Miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 e të Pasaportës së Indikatorëve”, të Urdhrit nr. 334, datë 7.10.2020, të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, urdhrin të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 158, datë 16.07.2021 “Për hartimin e Planit të Integritetit”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të Integritetit për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, bashkëlidhur këtij urdhri, i përgatitur nga Grupi i Punës i ngritur me urdhrin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 158, datë 16.07.2021 “Për hartimin e Planit të Integritetit”, i ndryshuar me urdhrin nr. 21, datë 19.01.2022.
2. Personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Integritetit do të caktohet: Znj. Ledina Beqiraj Agalliu, Sekretar i Përgjithshëm i MTM-së.
3. Personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit ka për detyrë të monitorojë zbatimin e Planit të Integritetit, veçanërisht planin e veprimit për menaxhimin e riskut të integritetit, si dhe të japë sugjerimet e nevojshme për përmirësimin e tij.
4. Të gjithë punonjësit e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit informojnë personin përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit, mbi gjendjen e integritetit të institucionit, për veprime apo ngjarje që mund të ndodhin e që mund të çojnë në cenimin e integritetit të institucionit.

5. Punonjësit e Institucionit, me kërkesë të personit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Integritetit, duhet të dorëzojnë të dhëna dhe informacione të nevojshme për zbatimin e planit te integritetit, të cilat nuk janë në kundërshtim me rregulloret në fuqi.
6. Së paku një herë në vit, por edhe më shpesh nëse është e nevojshme, personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit është i detyruar të paraqesë tek titullari i Institucionit një raport mbi zbatimin e Planit të Integritetit.
7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit e institucionit.
8. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR



Mirela KUMBARO FURXHI

Trajnim mbi zbatimin e detyrimeve mbi dhuratat,
favoret dhe trajtimet preferenciale për anëtarët e
kabinetit politik.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Hyrje

Standardet e sjelljeve të Qeverisë duhet të frymëzojnë besim.

Është e rëndësishme për anëtarët e Këshillit të Ministrave, duke qenë në një pozicion me pushtet dhe ndikim mbi jetën e qytetarëve, të sillen me respektin e duhur ndaj ligjshmërisë, besueshmërisë, solidaritetit, mos-diskriminimit, paanësisë, ndershmërisë, pavarësisë, objektivitetit, transparencës, llogaridhënies, shmangies së konfliktit të interesit dhe së fundmi, por jo nga rëndësia, mos abuzojnë me detyrën.

Ky trajnim ndihmon në ruajtjen e besimit të publikut, integritetit dhe paanësisë së Anëtarëve të Këshillit të Ministrave, duke treguar pritshmërinë më të ulët rreth sjelljes së pranueshme si dhe normën për sjelljen e tyre. Anëtarët e Këshillit të Ministrave duhet të përdorin gjykimin e tyre për të shmangur situatat e dhuratave, favoreve, premtimeve apo trajtimit preferencial të cilat ndalohen me ligj, pasi vetë veprimi i marrjes së tyre do t'i bënte këta anëtarë të dobët ndaj dhuruesit.

Fusha e veprimt

1. Anëtarët e Këshillit të Ministrave;
2. Kryeministrin, Zëvendëskryeministrin, Ministrat dhe Zëvendësministrat.

Baza Ligjore

Dhuratat, favoret dhe trajtimi preferencial trajtohen në dy nene të Kodit Etik Ministror, konkretisht neni 12 dhe neni 29:

- Neni 12, tregon veprimet e ndaluara për Anëtarët e Këshillit të Ministrave (KM) vis a vis abuzimit me kompetencat e tyre vendimmarrëse apo qoftë ato të lidhura me punësimin;
- Neni 29, rregullon dhuratat, favoret, premtimet dhe trajtimet preferenciale me më tepër imtësi;
- Ligji nr. 93677/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interes në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9131/2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” i zbatueshëm për zëvendësministrit;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 874/2021 “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administrates publike” i miratuar në zbatim të ligjit nr. 9131/2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

Dhuratat, favoret dhe trajtimet preferenciale

Dhuratat, favoret dhe trajtimet preferenciale janë interesa private dhe përfshijnë:

- Likuiditete në para në dorë;
- Likuiditete në llogari rrjedhëse;
- Likuiditete në depozitë;
- Likuiditete në bono thesari a rënuadhënie;
- Sende me vlerë;
- Çdo send me vlerë monetare, të premtuar, ofruar, dhënë falas ose nën vlerën e tregut;
- Çdo shërbim me vlerë monetare, të premtuar, ofruar, dhënë falas ose nën vlerën e tregut;
- interesat, aksionet dhe pjesët e kapitalit në shoqëri tregtare;
- Borxhet e detyrimet jozyrtare ndaj personave fizikë/juridikë;
- Ftesa për pritje të ndryshme;
- Premtime, ofrime falas apo ulje të çmimeve për kryerjen e shërbimeve, të argëtimeve, pushimeve, transporteve, udhëtimeve;
- Përfitime të bursave të studimit dhe/apo sigurimeve;
- Shmangia e çdo lloji humbjeje, premtime;
- Mbulim i shpenzimeve për kryerjen e shërbimeve apo veprimtarive të punonjësit.

Veprimet e ndaluar

Anëtarëve të Këshillit të Ministrave u ndalohet që në mënyrë të drejtëpërdrejtë/tërthortë, të kërkojnë, pranojnë, marrin për vete, familjarët, të afërmit e tyre, dhurata, favore, premtime apo trajtime preferenciale që jepen për shkak të detyrës së tyre zyrtare, nga një individ, person fizik/juridik, kur kjo mund të shkaktojë lëndjen e një konflikti interesi të çdo lloji, që ndikon ose duket se ndikon në paansinë e kryerjes së detyrës apo duket si shpërblim për kryerjen e detyrës zyrtare.

Ndalohen veprimet si më poshtë:

- Kërkimi/pranimi i shpërblimit/premtim shpërblimi lidhur me vendime të marra gjatë ushtrimit të funksionit;
- Fitimi i ndonjë të drejte apo pranimi i premtimit për fitimin e saj në rastet kur shkelet parimi i mos-diskriminimit;
- Keqpërdorimi i autorizimeve/delegimeve që rrjedhin nga ushtrimi i funksionit të tij publik;
- Kërkimi/përvetësimi/pranimi në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose jo, dhurata, sende me vlerë ose shërbime, në kompensim të votës së tij në vendimmarrjen kolegjiale apo individuale;
- Ndikimi në vendimin e ndonjë zyrtari apo organi për arsye të përfitimt material personal të familjarëve të tij apo personave të lidhur me ta;
- Premtimi i punësimit apo ndonjë të drejte tjetër në këmbim dhurate ose premtim dhurate;

Vazhdim

Ndalohen veprimet si më poshtë:

- Ndikimi në dhënie e pasurive ose fondeve publike të tretëve, për interes personal;
 - Shfrytëzimi për interes personal i informacioneve që posedon për shkak të funksionit;
 - Ndikimi në vendimmarrjen e organeve legislative, gjyqësore apo ekzekutive duke shfrytëzuar pozitën e tyre me qëllim të përfitimit personal, familjarëve të tij apo personave të lidhur me ta;
 - Marrja/dërmarrja e vendimeve që do të favorizojnë interesin privat të ndonjëpersoni tjetër, në dëm të interesit publik;
 - Udhëtimi në first class/business class në Evropë, ai dhe personeli që e shoqëron në udhëtime të ndryshme;
 - Pranimi i biletave të udhëtimit të paguara nga një person privat/kompani për veten/familjarët e tij;
 - Përdorimi sallës VIP të aeroportit nga familjarët e tij nëse nuk udhëton ai vetë;
 - Të përdorë automjetin zyrtar për familjarët e vetë ose nga 'ta nëse nuk është vetenë automjet;
 - Frekuencimi i ambienteve në të cilat zhvillohen aktivitetet të lidhura ekzkluzivisht me lojërat e fatit.
- Anëtarët e KM nuk duhet të pranojnë dhurata në vlera monetare, në asnjë rrethanë.

Rregulla të Përgjithshme

Rregullat të cilat përcaktojnë standardet e sjelljes së Anëtarëve të KM lidhur me martesën apo ofrimin e dhuratave, favorëve, premtimeve apo trajtimit preferencial, vijojnë si më poshtë:

- Anëtarëve të KM, u ndalohej që me cilësimin e nepunësis, të kërkojnë apo të marrin drejtëpërdrejti/vërthorazi, dhurata, favorë, premtime apo trajtim preferencial, nga persona fizikë, juridikë apo private;
- Anëtarët e KM, nuk duhet në asnjë rrethanë të kërkojnë ose pranojnë një dhuratë, favor, premtime apo trajtim preferencial me çfarëdo vlerë, në këmbim të njëvëndimi të qeverisë, punë, ngritje në detyrë apo ndëri të çfarëdo lloji;
- Oferta ndaj Anëtarëve të KM, për çfarëdo shume parash apo ekuivalentet në (bono thesari, kredi, likuiditete nëpara në dorë, depozitë etj.) klasifikohet si dhuratë dhe duhet refuzuar gjithmonë dhe, për hir të transparencës dhe integritetit, duhet të raportohet menjëherë me shkrim të Kryeministrit;
- Shërbimet apo mallrat që u ofrohen Anëtarëve të KM apo familjarëve të tyre, me kosto të ulët apo pa kosto, klasifikohen si formë dhuratae prandaj duhen refuzuar gjithmonë;
- Anëtarëve të KM u ndalohet t'ju japin dhurata vartësve të tyre, me përjashtim të dhuratave simbolike. Kryeministri është përgjegjës për cakimin e kufijve të lejuar;
- Anëtarët i KM nuk duhet që në mënyrë të drejtëpërdrejti ose tërthorë të japë dhurata apo të ndërhyjë për dhënie e dhuratave një nepunësi në nivel me të lartë ose familjarëve të tij;
- Anëtarët i KM nuk duhet që në mënyrë të drejtëpërdrejti ose të tërthorë për shkak të cilësive dhe marrëdhënies zyrtare, të kërkojë/pranojë dhurata nga nepunësi të një niveli më të ulët apo nga familjarët e tij/saj;
- Anëtarët e KM nuk duhet të kërkojnë apo nxisin ndonjë lloj dhurate gjatë kryerjes së detyrës si dhe duhet të përcjellin gjithmonë qëndrimin zyrtar përballë dhënies dhe martesës së dhuratave, ndërsa respektojnë zakonet, traditat kulturore dhe protokollet diplomatike.

Përijashitime nga Rregullat

Dhurata të lejueshme, favore, premtime apo trajtime preferenciale janë ato të cilat një person i arsyeshëm do të gjykonte se:

1. Nuk janë bërë për të ushtruar ndikim;
2. Kanë vlerë të ulët;
3. Jepen vullnetarisht si shprehje e mirësjelljes apo mikpritjes;
4. Po të refuzohen, shkaktojnë shqetësim/ofendim diplomatik.

Me ligj, 3 lloje dhuratash lejohen sipas fushës së veprimt të Kodit Etik Ministror:

- Dhurata Protokollare;
- Dhurata simbolike;
- Dhurata personale.

Vazhdim

Dhurata e leqjesme shkolle	Te papranueshme
<ul style="list-style-type: none">Mbulimi i vakreve apo ushqimit gjate nje aktiviteti sic ofrohet per githnje pjesemarrësit.Nje gimi apo dhurate e vogël qe jepet ne shenje falenderimi per pjesemarrje ne panelin e nje konference apo per fjalën e mbajtur ne nje aktivitet.Dhurata me vlerë te vogël si kalendare, gola, stillojapsa, karnica, magnetet frigofriferi, gjate ndjekjes së nje aktiviteti ne komunitet.Materialë informuese apo nje USB me logo ku përmbahen raporte/studime.	<ul style="list-style-type: none">Pagesa e nje vakti ne restorant nga nje pale interesi.Dhurate nganjë kompani ndërkombëtare gjate nje misioni tregtar.Biletë e nje aktiviteti kulturor/sportive ku ministri nuk luan rol zyrtar, nganjë pale interesi.

Procedurat e trajtimit të dhuratave, favoreve apo trajtimit preferencial

Detrimi për të refuzuar/kthyer dhuratat që nuk lejohen

- Anëtarët e KM duhet t'i refuzojnë hapazi ose t'ia kthejnë dhuruesit dhuratat e papranueshme, pa i hapur ato.

Detrimi për t'i deklaruar

- Anëtarët e KM janë të detyruar që t'i deklarojnë dhuratat e lejueshme, favoret, premtimet dhe trajtimet preferenciale çdo herë apo në mënyrë përmbljedhëse brenda një viti kalendarik, kur kanë vlerë më të madhe apo baraz me 10,000 lekë, të marra nga i njëjti person fizik apo juridik.
- Anëtarët e KM duhet të sigurohen se i kanë dhënë të gjithë hollësitë e nevojshme për të mundësuar një vlerësim të konfliktit të mundshëm të interesit me ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësisve, qoftë ky interes aktual apo i perceptuar.

Konsultimi dhe keshilla

- Në raste dyshimi nëse këto dhuratat, favore, trajtime preferenciale janë të pranueshme ose jo, anëtarët e KM duhet të konsultohen me Komisionin e Etikës dhe ILDKPKI.

Regjistrimi

- Dhuratat e lejueshme të marra nga Anëtarët e KM, me cilësitë e tyre personale apo zyrtare, regjistrohen në një regjistër, nga sekretari i përgjithshëm i ministrit së përkatëse. Dhuratat simbolike me vlerë më të vogël se 10,000 lekë përjashtohen nga detrimi. Dhuratat personale dhe protokollare regjistrohen në formularin enkas për to.
- Dhuratat protokollare që u jepen Anëtarëve të KM, me cilësitë zyrtare ose delegacioneve që i shoqërojnë ata, bëhen pasuri e shtetit.
- Në regjistra duhen shënuar nëse dhuratat protokollare mbahen apo shkatërrohen nëpërmjet një metode të përshatshme, që nuk e ofendon dhuruesin.

Konkluzione

Qëllimi i këtij trajnimi është krijimi i një mjedisi etik me standardet më të larta, duke nxitur subjektet që trajtohen për të prekur parimet, rregullat dhe procedurat e trajtuara më sipër nëpërmjet frymës së Kodit Etik Ministror dhe legjislacionin përkatës, përmes së cilave mund të arrihet qartësi, efikasitet dhe besim kundrejt bashkëqytetarëve.

Anëtarët e KM duhet të gjykojnë gjithmonë në mendje të shëndoshë dhe të sillen me etikë. Ata duhet të reflektojnë dhe të kontribuojnë në një mjedis të përshtatshëm pune dhe ofrimi shërbimesh publike, ku vlerat përcaktohen dhe modellet ekzemplare janë të ditura për gjithë administratën shtetërore. Është përgjegjësi e tyre të përqafojnë standardet më të larta morale me anë të një angazhimi të qartë e të pandalshëm.

Faleminderit!